

AKT THEMELIMI
I
SHOQËRISË TREGTARE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
“ZONJA WORK” SHPK

Ortaku themelues:

- z. Denis Duro, biri i Fatmir Duro dhe i Shkendije Duro, i datëlindjes 25.07.1993, lindur në Durrës dhe banues në Itali, madhor, me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, mbajtës i pasaportës numër BC3048501 dhe numër personal J30725080H, i lëshuar nga MPB e Republikës së Shqipërisë më datë 18-11-2020 dhe e vlefshme deri më 17-11-2030;

bazuar në ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008, “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” (i ndryshuar), ligjin nr. 9723, datë 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit” (i ndryshuar), sot më datë 19.11.2020, harton këtë Akt Themelimi të shoqërisë tregtare si më poshtë vijon;

NENI 1
Emri

- 1.1 Shoqëria tregtare mban emrin “ZONJA WORK” SHPK.
- 1.2 Ndryshimi i emërimit të shoqërisë mund të bëhet vetëm me vendim të Ortakut të Vetëm të shoqërisë.

NENI 2
Forma

- 2.1 Shoqëria tregtare “ZONJA WORK” SHPK, ka formën e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar.

NENI 3
Zyra Qendrore

- 3.1 Shoqëria tregtare me përgjegjësi të kufizuar “ZONJA WORK” SHPK, do të ketë zyrën e saj qendrore në adresën Qendra e Biznesit “Arena Center”, Tiranë.

NENI 4
Objekti i Veprimtarisë

- 4.1 Shoqëria do të ushtrojë veprimtarinë e saj tregtare në fushën e shërbimive ndaj shoqërive dhe personave të ndryshëm fizikë dhe juridikë, shërbime konsulence dhe coworking.

Konsulencë Financiare dhe Legale për kompanitë kombëtare dhe ndërkombëtare në mënyrë që ato të operojnë sukseshëm në Shqipëri. Konsulenca legale dhe financiare konsiston në çështje të ndryshme si: investime në fusha të ndryshme, bashkim dhe blerje të kompanive, ndërmarrje të përbashkëta, marrëveshje bashkëpunimi, ristrukturime të kompanive në vështirësi, marrëdhëniet me sistemin bankar, këshilla ligjore huadhënësve dhe huamarrësve për çështje të financimit.



NENI 5
Kohëzgjatja

5.1 Kohëzgjatja e aktivitetit të shoqërisë “ZONJA WORK” SHPK do të jetë me afat të pacaktuar.

NENI 6
Degët dhe Zyrat e Përfaqësimit

6.1 Shoqëria tregtare “ZONJA WORK” SHPK mund të hapë degë të saj ose zyra përfaqësimi brenda ose jashtë vendit.

NENI 7
Përgjegjësia e Ortakut

7.1 Ortaku nuk përgjigjet për detyrimet e shoqërisë “ZONJA WORK” SHPK dhe mbulon personalisht humbjet e shoqërisë deri në pjesën e pashlyer të kontributeve të nënshkruara prej tij.

NENI 8
Kapitali i Regjistruar dhe Kuotat

8.1 Kapitali i regjistruar i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar “ZONJA WORK” SHPK është 1,000 (një mijë) lekë.

8.2 Ortaku i Vetëm i shoqërisë është zotëruar i 1 (një) kuote me vlerë 1,000 (një mijë) lekë e cila përbën 100% të kapitalit të shoqërisë.

8.3 Kontributet që përbëjnë 100 % të kapitalit të regjistruar të shoqërisë janë shlyer tërësisht nga Ortaku i Vetëm Denis Duro.

NENI 9
Organet e Shoqërisë

Organet drejtuese të shoqërisë janë:

- Asambleja e Përgjithshme
- Administratori

Detyrat e organeve të shoqërisë do të përcaktohen në statutin e shoqërisë.

NENI 10
Administratori

Shoqëria administrohet nga një administrator që emërohet dhe shkarkohet nga Ortaku i Vetëm. Afati i emërimit është 3 vjet. Kompetencat e administratorit përcaktohen në statutin e shoqërisë.

Administratori i parë i Shoqërisë është znj. Parsiana Zaimaj, e bija e Lavdimir, e datëlindjes 15.07.1992, lindur në Durrës dhe banuese në Durrës, mbajtëse e pasaportës numër BB2743462 dhe numër personal J25715088H.

Ky Akt Themelimi përpilohet në 4 (katër) origjinale në gjuhën shqipe, të gjitha me të njëjtën vlerë ligjore.

ORTAKU THEMELUES

Denis Duro
